**KËRKESË**
**Nr. 3460, datë 31.7.2014**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga zbatimi i projektit të miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve nr. 27, datë 15.7.2014, "Për ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin "Nënë Tereza".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 30.7.2014, "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë".

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP", do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 36,107,184 (tridhjetë e gjashtë milion e njëqind e shtatë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh.

ZËVENDËSMINISTRI I KULTURËS
**Zef Çuni**

**LISTA E PASURIVE TE PALUAJTESHME PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER MARRJEN NE PERDORIM TE PERKOHSHEM PER INTERES PUBLIK , TE CILAT PREKEN NGA ____________**

| Nr | Pronari | Zona kadastrale | Nr. pasurie | Siperfaqe | | Çmimi Leke/m2 | | Vlera Leke | | | SHENIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Truall | Ndertim | Truall | Ndertim | Truallit | Ndertese | Banese | |
| 1 | FLUTURA HASAN CELA,<br>LILJANA PETROR SOTIRI,<br>NAZE HASAN SUBASHI,<br>QEMAL GEGA,<br>VJOLLCA NAGJELI<br>SHTETI | 8280 | 2/8-ND | | 104 | | 12445.71 | | 1,294,354 | | Plotesim dokumentacioni |
| 2 | HODO VELAJ<br>SHTET | 8160 | 7/11-N2 | | 94.5 | | 25769.97 | | 2,435,262 | | Plotesim dokumentacioni |
| 3 | ROVAN LIMON LUKU | 8280 | 2/327 | 72m2 | 299.8 | 23955 | 43894.79 | 1,724,760 | 13,159,659 | | Bllokuar ne favor te UNION BANK |
| 4 | PERSEFONI KRISTO KOKA | 8280 | 2/13 | 51m2 | 60.9 | 23955 | 23944.33 | 1,221,705 | 1,458,210 | | Konfirmuar nga ZRVPP |
| 5 | MAJLINDA XHEVAHIR ZALLA<br>VIPAUTO sh.p.k.<br>VIPAUTO SH.P.K.<br>LIONMAX KONSTRUKSION | 8280 | 2/337<br>2/336<br>2/11<br>2/267 | 22.9m2<br>22.9m2<br>31.6m2<br>25.5m2 | 104.5 | 23955 | 65961.67 | 2,464,970 | 6,892,995 | | 2/11 bllokuar ne favor te UNION BANK<br>2/336 Bllokuar ne favor te UNION BANK |
| 6 | MAK-ALBANIA sh.p.k.<br>SHTET | 8160 | 7/11-N3 | | 140 | | 34241.91 | | 4,793,867 | | Plotesim dokumentacioni |
| 7 | LILJANA PETRO SOTIRI<br>VJOLLCA RUSHIT ANGJELI<br>~~FLUTURA HASAN CELA~~<br>QEMAL LIAL GEGA<br>NAZE SUBASHI<br>SHTET | 8280 | 2/334-ND/2<br>2/334-ND/1 | 40m2 | 48.9 | | 13525.6 | | 661,402 | | Plotesim dokumentacioni |
| 8 | HODO VELAJ | 8160 | 7/11-N4 | 0 | 0 | | 0 | | 0 | | |
| 9 | | | | | | | | | | | |
| | | | | - | 852.6 | | | 5,411,435 | 30,695,749 | - | 36,107,184 |
| | TOTALI | | | | Leke | | | | | | |